

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës – Pune publike

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: Rikonstruksion i Rezervuarit të Domes, Bashkia Rrogozhinë

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP): 45243510-0

VLERA E FONDIT LIMIT: 62.660.994 (gjashtëdhjetë e dy milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër) leke pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Rrogozhinë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas shtojcës 8 të këtyre dokumentave.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Për të provuar aktivitetin pozitiv dhe të qëndrueshëm , operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tri) vitet e fundit financiare (2022, 2023, 2024) të paraqitur pranë në Autoritetet Doganore përkatëse , Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen Kontabël të Autorizuar. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Shënim. Akt ekspertiza e ekspertit kontabël të autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të ligjit nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar ku parashikohet se:

“Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese: c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii. ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël.”

***Argumentimi:** Kërkesa e mesiperme përcaktohet bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj kontrate si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP (i ndryshuar) si dhe nenin 43 e VKM-se nr.285 datë 19.05.2021” Për miratimin e rregullave të prokurimit public” (I ndryshuar).Percaktimi I vlerës së kerkuar është bërë bazuar në nenin 43 , pika 1 e VKM-se nr.285 datë 19.05.2021” Për miratimin e rregullave të prokurimit public” (I ndryshuar).*

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje për deklarinimin e xhirove vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se fondi limit i kontratës që prokurohet.**

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

***Argumentimi:** Kërkesa e mesiperme përcaktohet bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj kontrate si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP (i ndryshuar) si dhe nenin 43, pika 4 e VKM-se nr.285 datë 19.05.2021” Për miratimin e rregullave të prokurimit public” (I ndryshuar).Percaktimi I viteve të kerkuara është në përputhje me nenin 43, pika 4 e VKM-se nr.285 datë 19.05.2021” Për miratimin e rregullave të prokurimit public” (I ndryshuar si dhe përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të ligjit nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar .*

2.2.2 Vetëdeklarimin për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar për vitin 2025 sipas

përcaktimeve në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, cdo anëtar i bashkimit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës sipas adresave regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është bazuar në bazë të pikës 2, të nenit 76, të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe neni 43, pika 6, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar aftësitë teknike, OE duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme:

Përvojë të sukseshme në realizimin e:

- a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë **jo më të vogël se 45% e vlerës** së përllëgoaritur të kontratës objekt prokurimi, më konkretisht 62.660.994 (gjashtëdhjetë e dy milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër) leke pa tvsh, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b) Punë të ngjashme deri në kufir ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është **në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi I vlerës limit** të kontratës që prokurohet, konkretisht 62.660.994 (gjashtëdhjetë e dy milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër) leke pa tvsh.

Plotësimi i njërit nga të dy kushtet e lartpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Pika 2.3.1/b është e detyrueshme të plotësohet nga të gjithë anëtarët në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme përcaktohet bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP (i ndryshuar) si dhe nenit 39, pika 5 e VKM-se nr.285 date 19.05.2021” Per miratimin e rregullave te prokurimit public” (I ndryshuar).Përcaktimi I vleres se kerkuar eshte bere bazuar ne nenin neni 43 , pika 1 e VKM-se nr.285 date 19.05.2021” Per miratimin e rregullave te prokurimit public” (I ndryshuar). Me ane te ketij kriteri kerkohet qe operatorët ekonomike te deshmojne qe kane pervojën e nevojshme per te zbatuar kontratën objekt prokurimi, prandaj*

eshte kerkuar qe punet e meparshme te jene minimalisht nen vlerat 50% te vleres se fondit limit , per nje objekt te vetem ose jo me te vogel se dyfishi I vleres se fondit limit te kontrates qe prokurohet per punet totale te ngjashme te kryera ne 5 vitet e fundit. Percaktimi I vleres se kerkuar per kontratat e ngjashme argumentohet referuar nenin 77, pika 3, e LPP (i ndryshuar) si dhe nenit 39, pika 5 e VKM-se nr.285 date 19.05.2021” Per miratimin e rregullave te prokurimit public” (I ndryshuar).

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë dokumentat e mëposhtme për vlerësimin e përvojës së mëparshme:

a) Për kontrata të realizuara nga ente publike:

- i. Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
- ii. Kontrata sipërmarrjes;
- iii. Situacioni përfundimtar;
- iv. Akti I kolaudimit;
- v. Certifikata e marrjes në dorëzim / certifikata e perkohshme e marrjes ne dorezim.

b) Për kontrata të realizuara në sektorin privat:

- i. Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati I përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
- ii. Kontrata sipërmarrjes;
- iii. Situacioni përfundimtar;
- iv. Akti I kolaudimit;
- v. Certifikata e marrjes në dorëzim / certifikata e perkohshme e marrjes ne dorëzim.
- i. Fatura tatimore përkatëse e deklaruar në organet tatimore.

Për kontratat e realizuara si bashkim operatorësh , OE ofertues duhet të paraqes: kontratën e bashkimit të operatorëve ekonomikë shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve , ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE si dhe prokurën e posacme të deklaruar në faqen e tenderimit.

Argumentimi: *Kerkesa e mesiperme percaktohet bazuar ne nenin 77, pika 3, e LPP (i ndryshuar) si dhe nenit 39, pika 5 e VKM-se nr.285 date 19.05.2021” Per miratimin e rregullave te prokurimit public” (I ndryshuar).Percaktimi I vleres se kerkuar eshte bere bazuar*

ne nenin neni 43 , pika 1 e VKM-se nr.285 date 19.05.2021” Per miratimin e rregullave te prokurimit public” (I ndryshuar). Me ane te ketij kriteri kerkohet qe operatoret ekonomike te deshmojne qe kane pervojen e nevojshme per te zbatuar kontraten objekt prokurimi, prandaj eshte kerkuar qe punet e meparshme te jene minimalisht nen vlerat 50% te vleres se fondit limit , per nje objekt te vetem ose jo me te vogel se dyfishi I vleres se fondit limit te kontrates qe prokurohet per punet totale te ngjashme te kryera ne 5 vitet e fundit. Percaktimi I vleres se kerkuar per kontratat e ngjashme argumentohet referuar nenin 77, pika 3, e LPP (i ndryshuar) si dhe nenit 39, pika 5 e VKM-se nr.285 date 19.05.2021” Per miratimin e rregullave te prokurimit public” (I ndryshuar).

2.3.3 Një punësim mesatar i të paktën 70 (shatedhjetë) personave, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. Licença profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Të disponojë livencë profesionale të vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

- NP-1 C Punime gjermimi në tokë
- NP-2 B Ndërtime civile dhe industrial
- NP-4 C Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai,metro, pista aeroportuale
- NP-5 B Punime nëntokësore, ura e vepra arti
- NP-6 A Diga dhe tunele hidroteknike
- NP-7 C Ujësjiellës, gazsjellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje
- NP-9 C Punime dhe mborjtje lumore sisteme hidraulike dhe bonifikime
- NP-12 B Punime të inxhinierisë së mjedisit
- NS-1 B Punime për prishjen e ndërtimeve
- NS-18 Punime topogjeodezike
- NS-20 A Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë.

sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjisllacionit në fuqi.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) në Republikën e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në Nr.42, datë 16. 01. 2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht s'kualifikues.

Argumentimi: Ne baze te pikes 4 te nenit 77, pika 3, e LPP (i ndryshuar) si dhe nenit 39, pika 6/ç e VKM-se nr.285 date 19.05.2021” Per miratimin e rregullave te prokurimit public” (I ndryshuar), me ane te ketij kriteri kerkohet qe operatoret ekonomike te deshmojne qe kane fuqine minimale punetore, te nevojshem per realizimin e kontrates si dhe Vendimit te Keshillit te

Ministrave nr. 42 date 16.01.2008 “Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, kalsifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi”.

2.3.4 Duhet të disponohen të punësuar staf inxhinierik, për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licensën e operatorit ekonomik, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë punë, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë konkretisht:

- 1 (një) inxhinier ndërtimi (profili strukturist)
- 1 (një) inxhinier hidroteknik
- 1 (një) inxhinier elektrik
- 1 (një) inxhinier topograf/gjeodet/markshajder/gjeomatik
- 1 (një) inxhinier mekanik
- 1 (një) inxhinier gjeolog

Stafi i kërkuar si me siprcituar nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo te deklaruar në procedura të shpallura fituese.

Argumentimi: Bazuar ne piken 4 te nenit 77, pika 3, e LPP (i ndryshuar) si dhe nenit 39, pika 6/ç e VKM-se nr.285 date 19.05.2021” Per miratimin e rregullave te prokurimit public” (I ndryshuar), kerkohet qe operatoret ekonomike te deshmojne qe kane personelin e nevojshem te kualifikuar per realizimin me sukses te kontrates. Kriteri per stafin drejtues lidhet ngushte me objektin e kontrates, projektin, relacionet, dhe raportet teknike, specifikimet si dhe zerat e punimeve. Kriteri per stafin drejtues teknik lidhet ngushte edhe me kerkesat ne piken 2.3.3 te kriterave teknike. Mungesa e ketij stafi pothuajse ne cdo rast rezulton me realizim jashte afatit, jashte normave dhe me cilesi te dobet te objekteve. Numri I stafit kryesor si numri I inxhinierëve ne ndertim, elektrik, hidroteknik, gjeolog etj eshte percaktuar nga pikepamja e natyres teknike te kontrates me qellim per te patur nje rezultat sa me te mire ne mbarevajtjen dhe zbatimin e punimeve.

2.3.5 Të këtë të punësuar në stafin e tij 1 (një) punonjës specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin në përputhje me ligjin nr.152/2015. me klauzolat Ligjit Nr.152/2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin", Neni 49, pika 4, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin).

Argumentimi: Sipas nenit 71 të Ligjit 162/2020, autoriteti kontraktor ka të drejtë të vendosë kriteret të veçanta kualifikimi për të siguruar që operatorët ekonomikë kanë kapacitetet teknike dhe profesionale për të përmbushur kontratën në përputhje me kërkesat. Në këtë kontekst,

kërkesa për një punonjës specialist/ekspert zjarrfikës bazohet në objektin e kontratës, nëse lidhet me shërbime, punë ndërtimi apo operacione që përfshijnë risqe të larta zjarri, ambiente të mbyllura apo struktura që kërkojnë mbrojtje aktive nga zjarri dhe nevojën për garantimin e masave të sigurisë, sipas rregulloreve dhe standardeve teknike kombëtare dhe europiane.

Kërkesa për të pasur një punonjës specialist/ekspert zjarrfikës në një procedurë tenderimi është plotësisht e justifikuar, bazuar në:

- Nenin 71 të Ligjit 162/2020 për kriteret e kualifikimit;
- Ligjin nr. 8756/2001 për detyrimin ligjor të masave për mbrojtjen nga zjarri;

2.3.6 Të ketë personel të kualifikuar / certifikuar si:

- a) 1 (një) punonjës I pajisur me certifikate “Ekspert për ndihmën e Parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”
- b) 1 (një) punonjës I pajisur me certifikate “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” në përputhje me ligjin nr. 10327 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”/
- c) Operatorët ekonomikë, për të siguruar shërbimin mjekësor, duhet të kenë të punësuar një mjek të përgjithshëm ose të kenë këtë shërbim të kontraktuar nga jashtë.

Argumentimi: VKM-te per shendetin ne pune, percaktojne se te gjitha subjektet qe ushtrojne veprimtarine e tyre ne territorin e Republikes se Shqiperise, pavaresisht llojit te aktivitetit dhe numrit te punemaresve te tyre duhet te pajisen me mjek ndermarrje. Keto VKM percaktojne se ne baze te numrit te punetoreve, kohes se punes se mjekut ne nderrmarje, I cili mund te jete me kohe te plote , te pjesshme apo ndersubjektor. Gjithashtu keto VKM percaktojne peridiociteti I kryerjes se kontrollit periodic mjekesor, ne varesi te llojit te aktivitetit te subjektit dhe lloji I testeve ekzaminuese mjekesore ne varesi te pozicionit te punes se punemarresit. Lista e semundjeve profesionale percakton semundjen profesionale qe idhet direct me profesionin e pacientit dhe ekspozimin ne vendin e punes. VKM te per Shendetin ne Pune, vkm Nr. 636 date 7.9.2016 “Per percaktimin e rregullave, te procedurave e te llojeve te testeve ekzaminuese mjekesore , qe do te kryehen ne varesi te punes se punemarresit si dhe te menyres se funksionimit te sherbimit mjekesore ne pune”.

2.3.7 Operatorët ekonomikë duhet të kenë pjesë të stafit të tyre 1 (një) punonjës “Ekspert për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedisit”, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Argumentimi: Kërkesa që operatori ekonomik të përfshijë në ofertën e tij 1 ekspert të licencuar në Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM) është bazuar në Ligjin nr. 10440/2011(I ndryshuar) dhe VKM nr. 598/2015

2.3.8 Përveç stafit teknik, operatorët ekonomikë duhet të kenë të punësuar staf mbështetës si:

- karpentier 2 (dy)
- murator 2 (dy)

- hekurkthyes 1 (një)
- specialist ndërtimi 2 (dy)
- suvatues 2 (dy)
- hidroizolues 2 (dy)
- hidraulik 1 (një)
- elektrikist 2 (dy)
- shoferë 4 (katër)
- eskavatorist 2 (dy)
- buldozerist 1 (një)
- automakinist 1 (një)

Punonjësit duhet të jenë të deklaruar me emër/ mbiemër, duke cituar profilin e punës, numrin e kontratës individuale të punës, numrin e dëshmisë së aftësisë profesionale dhe afatin e vlefshmërisë së saj.

Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit në rastin kur punonjësit eskavatorist, automakinist, dhe buldozier janë të kontraktuar me kontratë pune respektivisht për mjete të marra me qera, operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të deklarojnë emrin /mbiemër, duke cituar profilin e punës, numrin e kontratës individuale të punës, numrin e dëshmisë së aftësisë profesionale dhe afatin e vlefshmërisë së saj, si dhe lejen e drejtimit.

Argumentimi: Ne baze të pikës 4 të nenit 77, pika 3, e LPP (i ndryshuar) si dhe nenit 39, pika 6/ç e VKM-se nr.285 datë 19.05.2021” Per miratimin e rregullave të prokurimit public” (i ndryshuar), me ane të këtij kriteri kerkohet qe operatorët ekonomike të deshmojne qe kane fuqine minimale punetore, te nevojshem per realizimin e kontrates.

2.3.9 Të disponojnë certifikatat ISO si më poshtë:

1. **ISO 9001 : 2015** – Certifikate e menaxhimit të cilësisë, e vlefshme e akredituar nga DPA ose nga Organizata Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, cdo anëtar I bashkimit duhet të paraqesë Certifikatën ISO 9001 : 2015.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 79, ”Standartet e sigrimit të cilësisë” të të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Përr shkak të natyrës së vecantë, vendodhjes dhe përmasave të objektit të kontratës që do të prokurohet, është e rëndësishme që operatorët të përmushin kontratën me standartet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë është standart për çdo subjekt juridik apo privat dhe ka qëllim në arritjen e suksesit. Referuar nenit 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standartet për menaxhimin e cilësisë, përfshirë edhe edhe standartet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë ISO 9001:2015

për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë: Është një standart ndërkombëtarë I dedikuar për sistemet e menaxhimit të cilësisë, I cili përshkruan një kornizë në përmirësimin e cilësisë për çdo organizatë që kërkon të ofrojë produkte dhe shërbime conform kërkesave dhe pritshmërisë së klientëve/palëve të interesuara në mënyrë më efektive të mundshme. Ndër të tjera ky standart harmonizohet me objektivat dhe planet e RSU NR.1 , në rritjen gjithënjë e më shumë të cilësisë në punët e përditshme dhe përafrimin me procedurat e ngajshme me vendet e tjera të zhvilluara.

2. ISO 14001 : 2015 – Certifikatë e menaxhimit të mjedisit e vlefshme e akredituar nga DPA ose nga Organizata Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar I bashkimit duhet të paraqesë Certifikaten ISO 14001 : 2015.

Argumentimi: Bazuar në Ligjin Nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe aktet nënligjore përkatëse që parashikojnë që çdo aktivitet ekonomik duhet të marrë masa për parandalimin, minimizimin dhe menaxhimin e ndotjes dhe ndikimeve mjedisore, duke aplikuar teknologji të pastra dhe sisteme menaxhimi mjedisor. Për rrjedhojë, kërkesa për certifikim ISO 14001:2015 në dokumentacionin e prokurimit është një mjet për të verifikuar se operatori ekonomik ka vendosur struktura të qëndrueshme të menaxhimit mjedisor, në përputhje me parimet e përgjegjësisë sociale dhe mjedisore. Kjo kërkesë për paraqitjen e certifikatës ISO 14001:2015 nga operatorët ekonomikë në procedurat e prokurimit është një praktikë e justifikuar dhe e dobishme, që siguron respektim të detyrimeve ligjore, përmirësim të cilësisë së shërbimit dhe minimizim të ndikimeve në mjedis.

3. ISO 45001 : 2018/ 45001:2023 Certifikatë e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit e vlefshme e akredituar nga DPA ose nga Organizata Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar I bashkimit duhet të paraqesë Certifikaten ISO 45001 : 2018 / 45001:2023.

Argumentimi: Kërkesa për ISO 45001 është në përputhje me Ligjin Nr. 10237, datë 18.2.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”; VKM-të dhe udhëzimet përkatëse për zbatimin e masave parandaluese, hartimin e planeve të sigurisë, dhe auditimin e risqeve profesionale; si dhe detyrimet që ka çdo subjekt që punëson, për të ofruar një ambient të sigurt dhe të shëndetshëm pune, në përputhje me standardet bashkëkohore. Kërkesa për paraqitjen e certifikatës ISO 45001:2018/2023 në procedurat e prokurimit është një mjet objektiv dhe legjitim për të siguruar që operatori ekonomik zbaton masat ligjore për sigurinë në punë si dhe ka kapacitete reale për të menaxhuar rreziqet profesionale.

4. ISO 50001 : 2018 – Certifikatë e menaxhimit të energjisë e vlefshme e akredituar nga DPA ose nga Organizata Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, operatori ekonomik që në bazë të marrëveshjes së

bashkëpunimit do të marrë përsipër realizimin e zërave elektrik të preventivit duhet të paraqesë këtë certifikatë ISO.

Argumentimi: ISO 50001 ndihmon në përmbushjen e kërkesave të Ligjit Nr. 124/2015 “Për Eficiencën e Energjisë”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 7/2017 “Për Menaxhimin e Energjisë”, Strategjisë Kombëtare të Energjisë 2018–2030 dhe Planit të Veprimit për Eficiencën e Energjisë, Detyrimeve që burojnë nga procesi i integritetit të Shqipërisë në BE, ku direktivat për eficiencën energjetike dhe menaxhimin e qëndrueshëm të energjisë janë kyçe. Kërkesa për paraqitjen e certifikatës ISO 50001:2018 në një procedurë prokurimi është një kriter teknik legjitim dhe strategjik, që siguron shfrytëzim efikas të burimeve energjetike, performancë të lartë dhe të qëndrueshme të kontratës së prokurimit dhe konformitet me legjislacionin shqiptar dhe angazhimet ndërkombëtare për klimën dhe energjinë.

5. **EN -ISO 3834 -2 : 2021** -Certifikate e menaxhimit të cilësisë në saldim, e vlefshme e akredituar nga DPA ose nga Organizata Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, cdo anëtar I bashkimit duhet të paraqesë Certifikaten EN -ISO 3834 -2 : 2021.

Argumentimi: Objekti i prokurimit përfshin punime, prodhime ose montime që lidhen me përdorimin e materialeve metalike dhe proceset e saldimit, të cilat janë kritike për qëndrueshmërinë, cilësinë dhe sigurinë e strukturave ose produkteve të kontraktuara. Në përputhje me parimin e transparencës, barazisë dhe sigurimit të cilësisë në prokurim, kërkesa për certifikim EN ISO 3834-2 është e arsyeshme për natyrën e objektit të prokurimit, e proporcionalizuar për të garantuar cilësinë e proceseve të saldimit dhe e nevojshme për të shmangur rreziqe teknike, siguri të munguar në strukturat metalike, apo mangësi në pajtueshmëri me standardet evropiane.

Për rrjedhojë, përfshirja e EN ISO 3834-2 si kriter i detyrueshëm kualifikimi teknik siguron zbatimin korrekt të kërkesave teknike të kontratës, cilësinë të garantuar gjatë gjithë ciklit të punës dhe përgjegjësi të lartë teknike nga operatori ekonomik.

2.3.10 Operatorët ekonomikë duhet të jenë të pajisur me ;

Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) **Kodi III.2.B** “Për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve të ngurta, inerte), mbështetur në Ligjin Nr. 9010, datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta” i ndryshuar me Ligjin Nr.10137, datë 11.5.2009 “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në republikën e shqipërisë”.

Argumentimi: Kërkesa bazohet në nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Per prokurimin publike” I ndryshuar, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, dhe ligjin nr.10463 datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar , VKM nr.538 datë 26.05.2009 “Për licensat dhe lejet, që trajtohen nga /apo nepermjet QKB dhe disa rregulla të tjera nenligjore të perbashketa”, VKM nr.229 date 23.4.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme”.

2.3.11 OE duhet të disponojë në pronësi, qira ose kontratë bashkëpunimi, impiantet si më poshtë;

- 1 (një) impiant prodhimi inerte
- 1 (një) impiant prodhimi betoni

Për impiantin e prodhimit të inerteve/betonit, në rast se është në pronësi duhet të paraqiten dokumente që vërtetojnë pronësinë e tij. Në rast se impianti i prodhimit të inerteve/betonit, është me qira ose kontratë bashkëpunimi, duhet të paraqitet kontrata e qirasë/bashkëpunimit, e vlefshme për periudhën e zbatimit të punimeve.

Argumentimi: Kjo kërkesë bazohet në nenin 71 të Ligjit 162/2020, në legjislacionin teknik për ndërtimet, si dhe në nevojën për garanci teknike, kontroll cilësie dhe përmbushje të rregullt të kontratës. Kjo kërkesë është thelbësore për realizimin me cilësi, efikasitet dhe siguri të kontratës, dhe nuk krijon barriera të pajustificuara në konkurrencë, pasi operatori mund të përmbushë kërkesën me pronësi ose me kontratë qiraje të ligjshme.

2.3.12 Operatori ekonomik duhet të disponojë leje mjedisore të leshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për grumbullimin dhe transportim të mbetjeve urbane” me **KOD III.2.B**

Argumentimi: Kjo kërkesë bazohet në nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në Ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i cili përcakton se subjektet që merren me menaxhimin e mbetjeve duhet të jenë të licensuar përkatësisht për çdo hallkë të zinxhirit të menaxhimit, përfshirë grumbullimin dhe transportimin, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.06.2003 “Për klasifikimin e mbetjeve dhe kriteret për lejimin e tyre”, ku mbetjet urbane janë të kategorizuara dhe kërkojnë trajtim nga subjekte me kapacitete teknike dhe administrative të miratuara, Udhëzimin përkatës të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit mbi licencimin e aktiviteteve me ndikim në mjedis, ku për grumbullim dhe transport të mbetjeve kërkohet leje me kodin specifik III.2.B.

2.3.13 Dëshmi të nevojshme për mjetet dhe pajisjet që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, për plotësimin e kontratës:

Nr.	Emri i mjetit	Njësi	Sasi	Statusi
1	Eskavator me kovë 0.5 m3, me zinxhirë	Copë	1	Në pronësi ose me qira
2	Eskavator me goma	Copë	2	Në pronësi ose me qira
3	Kamioncinë me kapacitet mbajtës nga 1 deri në 3 ton	Copë	2	Në pronësi ose me qira
4	Kamion me vinç	Copë	1	Në pronësi ose me qira
5	Auto vetëshkarkues (kamion) (20 ton)	Copë	2	Në pronësi ose me

				qira
6	Auto vetëshkarkues (kamion) (10-20 ton)	Copë	2	Në pronësi ose me qira
7	Vinç kullë (4-6 ton)	Copë	1	Në pronësi ose me qira
8	Auto vinç deri në 2.5 ton	Copë	1	Në pronësi ose me qira
9	Autobot uji	Copë	1	Në pronësi ose me qira
10	Rul vibrues gomë-hekur me kapacitet mbi 12 ton	Copë	1	Në pronësi ose me qira
11	Grejder	Copë	1	Në pronësi ose me qira
12	Betoniëre 500 L	Copë	2	Në pronësi ose me qira
13	Autobetoniëre	Copë	2	Në pronësi ose me qira
14	Autopompë betoni	Copë	1	Në pronësi ose me qira
15	Trencher për hapje kanali	Copë	1	Në pronësi ose me qira
16	Vibrator thelësie	Copë	2	Në pronësi ose me qira
17	Vibrator sipërfaqësor	Copë	2	Në pronësi ose me qira
18	Elektrosaldatriçe	Copë	1	Në pronësi ose me qira
19	Aparat për kthim hekuri, tranxhë hekuri	Copë	1	Në pronësi ose me qira
20	Fadrom me kovë para dhe krahë mbrapa/skrep me targa	Copë	2	Në pronësi ose me qira
21	Betoforma	Copë	200 m2	Në pronësi ose me qira
22	Depozita uji minimumi 5000 L	Copë	1	Në pronësi ose me qira
23	Kokore	Copë	100	Në pronësi ose me qira
24	Jelekë fosforeshentë	Copë	100	Në pronësi ose me qira
25	Moto gjenerator ≤ 50 kv	Copë	1	Në pronësi ose me qira
26	Damper kantieri	Copë	1	Në pronësi ose me qira
27	Çekiç për prishje betoni	Copë	1	Në pronësi ose me qira

28	Korrëse bari për bimë të vogla	Copë	3	Në pronësi ose me qira
29	Tabela sinjalizuese kantieri	Copë	15	Në pronësi ose me qira
30	Komplet i ndihmës së shpejtë	Copë	45	Në pronësi ose me qira

a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet:

- i. Dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë)
- ii. Leje qarkullimi
- iii. Certificate e kontrollit teknik (e vlefshme)
- iv. Siguracion mjeti (i vlefshëm)
- v. Certificate për transport mallrash brenda vendit(e vlefshme)

b) Për mjetet e marra me qira duhet të paraqiten:

- i. Kontrata përkatëse noteriale e qirasë (e vlefshme gjatë gjithë periudhës së realizimit të kontratës objekt prokurimi)
- ii. Dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë)
- iii. Leje qarkullimi
- iv. Certificate e kontrollit teknik (e vlefshme)
- v. Siguracion mjeti (i vlefshëm)
- vi. Certificate e kontrollit teknik (e vlefshme)
- vii. Siguracion mjeti (i vlefshëm)
- viii. Certificate për transport mallrash brenda vendit(e vlefshme)

c) Për mjetet e deklaruar që transportojnë mallrat të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqitet certifikatë (e vlefshme) për transport mallrash të rrezikshme të lëshuar nga institucionet përkatëse.

d) Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes / fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes, ndërsa kur janë të marra me qira duhet të paraqitet kontrata e qirasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së, duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.

Operatori ekonomik, duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruar në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti

Kontraktor. Operatori ekonomik, duhet të paraqesë një deklaratë për vendodhjen e mjeteve në pronësi ose me qira, me qëllim verifikimin nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 4, e ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39 pika 6/ç dhe 6/d të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit që ka në dispozicion apo që mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Për të përcaktuar nr e mjeteve / makinerive të ndryshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike sipas legjislacionit në fuqi, konkretisht VKM nr. 629 datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre".

Kriteri vlerësohet si i nevojshëm për ekzekutimin me sukses të kontratës objekt prokurimi.

2.3.14 Operatorët Ekonomikë, në përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivin përkatës të publikuar në DST, për materialet si më poshtë:

- a) Mates Nivel Uji ne Dige
- b) Piezometer
- c) Inklinometer
- d) Sistem akustik alarmi
- e) Sistem GPRS transmetim dhe monitorim ne distance

duhet të paraqesin:

- Autorizim të Prodhuesit / ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, ëbsite, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.
- Katalogun / et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit / ve për listën e mësipërme të artikujve në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Shënim: Fragmentet e Katalogut / ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përket.

Argumentimi: Bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, Ligji nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore" i ndryshuar, përcakton detyrimin për monitorimin e sasisë dhe cilësisë së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, ku përfshihet përdorimi i pajisjeve matës, Ligji nr. 8752/2001 "Për përgjegjësitë përkatëse në fushën e ndërtimit" i ndryshuar,

kërkon që të zbatohen normat teknike dhe siguria në ndërtim, ku matjet gjeoteknike janë thelbësore për stabilitetin e strukturave, Ligji nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” dhe Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë kërkojnë sisteme paralajmëruese efektive dhe të integruara në strukturat që përbëjnë rrezik për jetën apo mjedisin.

2.3.15 Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentet standarte të tenderit për 6 (gjashte) muaj.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim:

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë formularin e ofertës, sipas kërkesave të përcaktuara në shtojcën 1, pjesë e këtyre dokumentave të tenderit.

Gjithashtu, operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë edhe preventivin e punimeve I cili është vënë në dispozicion nga Autoriteti Kontraktor, pjesë e këtyre dokumentave të tenderit. Në zbatim të pikës 1, të nenit 26 të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit public”, I ndryshuar, ku parashikohet se “bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet be pikës 6, të këtij neni:

- Dokumentet përkatëse vërtetuese për disponimin e punonjësve do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.
- Autoriteti Kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit do të kërkojë ofertuesit të kualifikuar nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentat e tjera të paraqitura në sitemin e elektronik të prokurimit gjatë fazës së

ofertimit. Mosparaqitja e dokumentacionit të lartëpërmendur do të jetë kusht për skualifikim.

- *AK do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimet e bëra në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht skualifikimi.*